



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2754/prot.

Urë Vajgurore, më 14.10.2024

3

VENDIM

Nr. 44 Datë 14. 10.2024

“Për miratimin e vlerës e qirasë së ambienteve private, të cilat do të funksionojnë si kopësht/shkollë për tu përdorur për nevoja të Bashkisë Dimal”.

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Sektori i Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.6 paragrafi a, neni 23 pika 12 dhe nenet 41, 53, 54 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu VI, neni 801 e në vijim, Ligji Nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.52 datë 26.12.2023 “Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetin e detajuar për vitin 2024”.

VENDOSI :

Me 14 vota PRO, nga 14 Këshilltarë prezentë :

1. Të miratojë vlerën e qirasë në ambientet private, të cilat do të funksionojnë si kopësht/shkollë për t'u përdorur për nevoja të Bashkisë Dimal, sipas vlerave të mëposhtme :
 - Të miratojë vlerën e qirasë 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj, për ambientin e marrë me qira për arsimin fillor dhe 9 – vjecar, vlerë ku do të përfshihen edhe shpenzimet për energji elektrike në fshatin Donofrosë, në pronësi të subjektit qiradhënës Ymerli Dushku.
 - Të miratojë vlerën e qirasë 17 000 (shtatëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për ambientin e marrë me qira për arsimin parashkollor vlerë ku do të përfshihen edhe shpenzimet për energji elektrike në fshatin Polizhan , në pronësi të subjektit qiradhënës Ardit Çobo.

- Të miratojë vlerën e qirasë 17 000 (shtatëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për ambientin e marrë me qira për arsimin parashkollor vlerë ku do të përfshihen edhe shpenzimet për energji elektrike në fshatin Donofrosë , në pronësi të subjektit qiradhënës Përparim Minaj.
2. Të miratojë pagesën e qirasë, për furnizim me ujë për shkollat/kopshtet në vlerën 3000 lekë në muaj për 5(pesë) institucione arsimore kopshte shkolla sipas listës bashkëlidhur.
 3. Kontrata me subjektet do të lidhet për një afat 1-vjecar nga momenti i nënshkrimit nga palët.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
 5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
AVDULLA SALILLARI**



Kontrata qiraje per kopshte dhe shkolla viti mesimor 2024-2025

Nr.	Njësia Administrative	Emër	Mbiemër	Qëllimi /Objekti	Vendndodhja
1	Poshnje	Ardit	Cobo	ambient me qira per kopshtin	Polizhan
2	Cukalat	Ymeri	Dushku	ambient me qira per shkollen	Donofrosë
3	Cukalat	Pëparim	Minaj	ambient me qira per kopshtin	Donofrosë

Kontrata furnizimi me
uji ne kopshte e shkolla
viti mesimor 2024-2025

Nr	Njësia Administrative	Emër	Mbiemër	Qëllimi	Objekti
1	Ura Vajgurore	Petrit	Baci	Furnizim me uji	Shkolla Bistrovicë
2	Poshnje	Xhelal	Xhelo	Furnizim me uji	Kopshti Banaj
3	Kutalli	Elton	Zeka	Furnizim me uji	Kopshti Kutalli
4	Cukalat	Halim	Cela	Furnizim me uji	Shkolla Slanicë
5	Cukalat	Gëzim	Nasufi	Furnizim me uji	Shkolla Cetë

9/ Sektori Arsimor Kulturës

Zesjona Hoxha

